

PROTOKOLL

për bashkëpunim

midis

Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të Republikës së Shqipërisë

dhe

Rojës së Doganave dhe Financës të Republikës së Hungarisë

me qëllim implementimin e Protokollit 6 për asistencë administrative të ndërsjelltë në çështjet doganore, të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit midis Komuniteteve Europiane dhe shteteve të tyre anëtare nga njëra anë dhe Republikës së Shqipërisë nga ana tjetër, nënshkruar në Luksemburg më 12 qershor 2006.

Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisioneri i Rojës së Doganave dhe Financës të Republikës së Hungarisë (këtej e tutje referuar si palët), kanë rënë dakord si më poshtë:

Palët bien dakord që të zhvillojnë dhe forcojnë bashkëpunimin midis dy administratave doganore dhe nxisin efikasitetin e dy organizatave nëpërmjet shkëmbimit të njohurive dhe eksperiencës.

Bashkëpunimi i përmendur në këtë Protokoll bazohet në Protokollin 6 për asistencë administrative të ndërsjelltë në çështjet doganore të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit midis Komuniteteve Europiane dhe shteteve të tyre anëtare nga njëra anë dhe Republikës së Shqipërisë nga ana tjetër, nënshkruar në Luksemburg më 12 qershor 2006.

Palët bien dakord që shkëmbimi i informacionit lidhur me procedurat e zbatueshme doganore, duke përfshirë zhdoganimin e mallrave të eksportit dhe importit dhe informimin e ndërsjelltë për mënyrat e zgjidhjes së problemeve që lindin gjatë implementimit praktik të zhdoganimit, do të ndihmojnë në nxitjen e tregtisë ndërmjet dy vendeve.

Palët bien dakord që arsyetohet të ndërmarrin masa të përbashkëta brenda sferës së autoritetit dhe kompetencës së tyre, për parandalimin e çdo lloj shkeljeje të legjislacionit doganor me qëllim mbrojtjen e interesave ekonomike të dy vendeve.

Me qëllim arritjen e procedurave të koordinuara dhe efektive, palët e konsiderojnë të rëndësishme t'u vënë në dispozicion ekspertëve të palës tjetër legjislacionin e tyre doganor dhe të informojnë njëri tjetrin në mënyrë reciproke për implementimin e legjislacionit doganor dhe rezultatet e arritura në këtë fushë.

Përveç thjeshtimit të procedurave, palët konsiderojnë të rëndësishme trajnimin e ekspertëve doganorë të tyre me qëllim implementimin e këtij Protokolli.

Bazuar në parimet e lartpërmendura palët bien dakord si më poshtë:

1. Palët do të informojnë njëra-tjetrën për legjislacionin doganor, thjeshtimet, harmonizimet e zbatuara në Shqipëri dhe Hungari dhe rastet e interesit të përbashkët.
2. Palët do të informojnë njëra-tjetrën për rezultatet profesionale të arritura nga administratat e tyre doganore, metodat që aplikohen, veçanërisht në fushën e thjeshtimit dhe harmonizimit të procedurave doganore.
3. Me qëllim forcimin e bashkëpunimit midis dy administratave doganore, palët do të vendosin pika kontakti për realizimin e detyrave të caktuara.
4. Me qëllim përmirësimin e bashkëpunimit bilateral të administratave doganore, palët do të shkëmbejnë njohuritë dhe eksperiencën e tyre në këtë fushë.
5. Palët do të këshillohen për vështirësitë dhe objektivat që lindin gjatë implementimit praktik të legjislacionit doganor dhe procedurave doganore, për zgjidhjet e përshtatshme dhe marrjen e masave me qëllim nxitjen e tregtisë bilaterale.

Pala Hungareze ka shprehur gadishmërinë të ndajë përvojën e saj të fituar me hyrjen e Republikës së Hungarisë në Bashkimin Europian me ekspertët e Palës Shqiptare, me qëllim nxitjen e harmonizimit të sistemit Shqiptar me sistemin doganor të Komunitetit.

Palët bien dakord që të zhvillohen takime midis shefave të ekspertëve të të dy administratave doganore që të diskutojnë çështje dhe raste të miratuara në mënyrë të ndërsjelltë, në një datë dhe sipas një axhende, për të cilën të dyja palët kanë rënë dakord.


Pala Shqiptare ka njoftuar që në zbatimin e këtij protokolli do të veprojë në përputhje me Protokollin 6 për asistencë administrative të ndërsjelltë në çështjet doganore të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit midis Komuniteteve Europiane dhe Shteteve të tyre anëtare nga njëra anë dhe Republikës së Shqipërisë nga ana tjetër, nënshkruar në Luksemburg më 12 qershor 2006.


Pala Hungareze ka njoftuar që në zbatimin e këtij protokolli do të veprojë në përputhje me Marrëveshjen e hyrjes së Republikës së Hungarisë në Bashkimin Europian nënshkruar në Athinë më 16 prill 2003 dhe me legjislacionin e saj kombëtar.

Palët deklarojnë që Marrëveshja e Interimit për tregtinë dhe çështje që lidhen me tregtinë ndërmjet Komunitetit European nga njëra anë dhe Republikës së Shqipërisë nga ana tjetër, nënshkruar më 12 qershor 2006, ka hyrë në fuqi më 1 dhjetor 2006 duke nxitur bashkëpunimin pa probleme deri në hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ndërmjet Komuniteteve Europiane dhe Shteteve Anëtare të tyre, nga njëra anë dhe Republikës së Shqipërisë nga ana tjetër, nënshkruar në Luksemburg më 12 qershor 2006.

Ky protokoll është përpiluar dhe nënshkruar bazuar në Nenin 3; 4; 13 dhe 14 të Protokollit 6 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit për asistencë administrative të ndërsjelltë për çështjet doganore midis Komuniteteve Europiane dhe Shteteve Anëtare të tyre, nga njëra anë dhe Republikës së Shqipërisë nga ana tjetër, nënshkruar në Luksemburg, më 12 qershor 2006 dhe në nenet 3; 4; 13 dhe 14 të Protokollit 5 për asistencë administrative të ndërsjelltë në çështjet doganore, të Marrëveshjes së Interimit për tregti dhe çështje që lidhen me tregtinë midis Komunitetit European nga njëra anë dhe Republikës së Shqipërisë nga ana tjetër, nënshkruar në Luksemburg, më 12 qershor 2006.

Nënshkruar në Budapest, më 28 shkurt 2007, në dy kopje origjinale në gjuhët Shqip, Hungarisht, dhe Anglisht, ku të gjitha tekstet janë njëlloj autentike. Në rast divergjence për shkak të përkthimit, do të mbizotërojë teksti në Anglisht.


.....
Përparim Dervishi
Drejtor i Përgjithshëm


.....
János Nagy Dr.
Major Gjeneral
Komisioner